




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 28.09.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.09.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 993, të datës 09.09.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhet, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2017

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2017 në shumë të përgjithshme prej 9,540,837.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike buxhetore si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 720 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,373,544.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 604,569.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunale, buxheti i komunës është në shumë prej: 150,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione dhe transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 274,675.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,138,049.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive Komunale dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

No./Nr. _____ 129

Date/Data _____ 04.10.2016

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS

Datë: 04.10.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.09.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1040, të datës 16.09.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, Nenin 61, paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për refuzimin e emërimit të Nënkryetarit të Komunës për Komunitete

1. Për refuzimin e aprovimit të propozimit Nr. 1040, të datës 16.09.2016, për emërimin e z. Traja Jovanović, i lindur me datën 15.10.1961 në Prishtinë, me vendbanim në fshatin Uglarë Komuna e Graçanicës, në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.
2. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Udhëheqësit të Personelit, Palës dhe Arkivës.**



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi